



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2021

VENDIM
Nr. 190, datë 07.05.2021

PËR
NDËRPRERJEN E TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM DHE KOMANDIMIN NË
SKEMËN E DELEGIMIT TË GJYQTARIT Z. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61, në shkronjat “c” dhe “ë”, të nenit 86 dhe nenin 97, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 45 dhe 46, të Ligjit nr.96/2016, “Per statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në pikat 3, 4 dhe 6, të nenit 4 dhe pika 1.2, e nenit 5, të Vendimit të tij nr. 23, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, për shkak të situatës që krijohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë referuar Shkresës së saj nr.116 prot., datë 27.04.2021, protokolluar me aktin nr.1841, datë 29.04.2021, si dhe mbasi shqyrtoi edhe kërkesat e gjyqtarit z. {...}, atë të datës 20.04.2021, protokolluar me aktin nr.1687, datë 20.04.2021, atë të datës 28.04.2021, protokolluar me aktin nr.1842, datë 29.04.2021 dhe atë të datës 30.04.2021, protokolluar me aktin nr.1842/1, datë 30.04.2021, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Ndërprerjen e transferimit të përkohshëm me pëlqim të gjyqtarit z. {...}, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër sipas Vendimit nr.202, datë 11.06.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Komandimin e gjyqtarit z. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri më datë 31.05.2022.
3. Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.
4. Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} ngarkohet me pesëdhjetë për qind të ngarkesës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.
5. Gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} ngarkohet me pesëdhjetë për qind të ngarkesës së gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, si dhe për për gjykimin e çështjeve që do të ketë në shqyrtim në këtë gjykatë në datën e ndërprerjes së transferimit të përkohshëm dhe komandimit në skemën e delegimit.
6. Efektet juridike të vendimit fillojnë më datë 11.05.2021.

7. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë.
8. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR